

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO  
FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË  
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST  
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND  
ARKIVI - ARHIVA - ARCHIVE

Nr.Br.No. R 100 / 2023

Nr. i fq./Br.Str./No.pg. 6/9

Data/Datumi/Date: 22.05.2023

PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-lizazna

Nr. -11-687  
Br.

Data 22.05.2023  
Datum



## Marrëveshja për Inicim të Projektit Emergjent

për

Masat e Eficiencës së Energjisë

në

### Ndërtesat Shumë-Banesore Sociale në Pronësi të Komunave

Kjo Marrëveshje për Inicim të Projektit Emergjent për Masat e Eficiencës së Energjisë në Ndërtesat Shumë-Banesore Sociale në pronësi të Komunave (tutje referuar si "Marrëveshja") lidhet nga dhe në mes të:

1. Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë (në tekstin e mëtejme "FKEE") me adresë Rr. Luan Haradinaj (ish Banka e Lubjanës), 10000 Prishtinë e përfaqësuar nga Ahmet Ismaili, Drejtor Menaxhues (në tekstin e mëtejme "FKEE"); dhe
2. Komuna e Obiliqit, e përfaqësuar nga Kryetari Xhafer Gashi, (në tekstin e mëtejme "Komuna")

Tani e tutje referuar ndaras si FKEE, Komuna dhe bashkërisht si Palët në këtë Marrëveshje.

### Recitalet

DUKE QENË SE, Qeveria e Kosovës dhe Komisioni Evropian me datë 24 shkurt 2023 kanë nënshkruar Marrëveshje Financiare IPA III e cila ndër programe tjera, ka për objektivë sigurimin e qasjes në energji të përballueshme, të besueshme dhe të qëndrueshme për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës (Objektiva e Zhvillimit të Qëndrueshëm Nr. 7);

DUKE QENË SE, Qeveria e Kosovës përmes vendimit Nr.29/112 të datës 13.12.2022, duke ndryshuar dhe plotësuar Planin e Veprimtë për Zbutjen e Ndikimit të Menjëhershëm Socio-Ekonomik të Krizës Energjetike, e cila përfshinë Masën 3 – "Mbështetja e konsumatorëve individual familjar duke përfshirë konsumatorët në nevojë përmes rritjes së eficiencës së energjisë në njësitë e banimit dhe ndërtesa. Kjo masë do të zbatohet nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë duke zgjeruar fushëveprimin e FKEE-së në sektorin rezidencial;

DUKE QENË SE, FKEE fillimisht është duke e zbatuar masën për ndërtesat shumë banesore sociale në pronësi të komunave (tutje "Projekti Emergjent") e cila ka për synim konsumatorët në nevojë të ndërtesave shumë banesore në të cilat banojnë familjet dhe qytetarët e kësaj kategorie, në ndërtesa të cilat janë në pronësi publike nga komunat;

4.

DUKE QENË SE, FKEE përmes thirrjes publike drejtuar komunave të Kosovës për t'u bërë pjesë e Projektit Emergjent, ka përzgjedhur Komunën e Obiliqit (tutje referuar si "Komuna").

PRANDAJ, FKEE dhe Komuna lidhin këtë Marrëveshje për Inicim të Projektit duke definuar të drejtat dhe detyrimet e tyre në fazën fillestarë të zbatimit të Projektit Emergjent si në vijim:

#### Neni 1 Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi kryesor i Marrëveshjes është definimi i të drejtave dhe detyrimeve të Palëve në zbatimin e Projektit Emergjent, përkatësisht zbatimin e masave të efijencës së energjisë në ndërtesat shumë-banesore sociale në pronësi të Komunës.

#### Neni 2. Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella, FKEE dhe Komuna pajtohen me kushtet kontraktuale të përcaktuara si në vijim:

1. FKEE, si entitet i pavarur me mandat ligjor nga Ligji për Efijencë të Energjisë dhe konform autorizimeve të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, do të zbatoj Projektin Emergjent në përputhje me (i) Dokumentin e Projektit të Masave të Efijencës së Energjisë për Ndërtesa shumë banesore sociale të miratuar nga Bordi Drejtues dhe me pëlqim nga ministritë përkatëse, si dhe (ii) Doracakun Operacional të FKEE (në tekstin e mëtejme "DO").
2. Komuna, si person juridik, pasi ka konsideruar se plotëson kushtet e paraqitura në Shpalljen Publike, nën përgjegjësinë e saj të plotë, ka aplikuar pranë FKEE-së për përkrahje financiare për implementimin e Masave për Efijencë të Energjisë (tutje referuar si "MEE") në Sektorin Rezidencial, respektivisht në ndërtesat shumë-banesore sociale në pronësi të Komunës, për të cilin FKEE pas vlerësimit të dokumentacionit dhe duke marrë të mirëqene deklarinimin formal të Komunës të shprehur zyrtarisht në Formularin e aplikimit dhe dokumentet shoqëruese të paraqitura me aplikim, FKEE konstaton se i njëjti është i pranueshëm bazuar në kriteret e përcaktuara në Thirrjen Publike të publikuar në 07.04.2023
3. Komuna pranon FKEE-në si ofrues i kualifikuar i shërbimeve profesionale që do të rezultojnë në përfitime të rëndësishme në Kursim (kosto) të Energjisë dhe Buxhetit, si dhe për t'i përmirësuar nivelet e mirëqenies dhe standardet e jetesës për përdoruesit e objekteve komunale, dhe shërbimet e të cilit mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: analizën e përdorimit të energjisë (auditimin e energjisë), skemat e detajuara dhe specifikimet teknike për masat e efijencës së energjisë, përfshirë këtu sistemet dhe pajisjet që duhet të instalohen dhe të mirëmbahen, punimet në ndërtim, mbikëqyrjen e implementimit, trajnimin bazë të punonjësve përfitues dhe monitorimin e Projektit Komunal të Efijencës së Energjisë (ne

8.

tekstin e mëtejme "PKEE") siç parashikohet këtu dhe komisionimin e shërbimeve.

4. Komuna pajtohet dhe kupton faktin se përshtatshmëria me kushtet e thirrjes, lista e masave që duhet të implementohen dhe aspekte tjera, varen nga rezultatet e auditimit të energjisë dhe dizajnit, që kontraktohen nga FKEE, dhe të cilat diskutohen me komunën përfituese para fillimit të zbatimit të projektit.
5. Palët bien dakord që ta iniciojnë implementimin e PKEE të Komunës me seli në adresën [rruga] [numri], [kodi postar] [qyteti], në Republikën e Kosovës. Lista e projekteve që janë pjesë e kësaj marrëveshje paraqitet si shtojca 1 e këtij dokumenti.
6. Palët janë të zotuar që t'i ndjekin dispozitat e DO, e cila do të konsiderohet si pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshje, gjatë zbatimit të PKEE.
7. Duke pranuar këtë Marrëveshje, Komuna konfirmon se pajtohet me realizimin e projektit sipas specifikimeve teknike të përcaktuara nga FKEE, dhe e jep pëlqimin FKEE-së që të veprojë si *Agjent Implementues* në emër të tij dhe të angazhohet në bazë konkurruese me kompanitë për të ofruar shërbime profesionale për (i) Auditimin e Energjisë, (ii) Dizajnin, Mbikëqyrjen dhe Komisionimin dhe (iii) Realizimin e Punimeve, përfshirë furnizimin me pajisjet dhe materialet e nevojshme.
8. Palët po ashtu pajtohen që të nënshkruajnë Marrëveshje Bashkë-Financimi për të financuar Projektin Emergjent (tutje referuar si "MBF") ashtu që FKEE do të financojë 90% të vlerës së përgjithshme të projektit emergjent, ndërsa Komuna 10% të kostos së tij. Pas përzgjedhjes së Kontraktuesit për furnizimin e punimeve, Komuna në përputhje me metodologjinë e kalkulimit të përcaktuar nga FKEE do ta kompensojë FKEE për kostot e investimeve të PKEE. Detajet lidhur me Skemën e Kompensimit të Investimeve do të përcaktohen në MBF.
9. Kostoja e shërbimeve tjera të ofruara nga FKEE, përfshirë menaxhimin financiar, prokurimin dhe mbikëqyrjen teknike do të kompensohen njësoj (10%) dhe nuk do të përfshijë ndonjë tarifë të menaxhimit nga FKEE, në përputhje me termat dhe kushtet që do të përcaktohen në MBF.
10. Komuna do të siguroj qasje të plotë dhe pa penguar për FKEE, stafin e tij dhe përfaqësuesit, përfshirë kontraktuesit e FKEE, në lokacionin e ndërtesës shumë-banesore sociale.
11. Palët do të themelojnë një Grup Koordinues për njoftim paraprak të banorëve dhe koordinim gjatë zbatimit të Projektit Emergjent me pjesëmarrës: FKEE, Komuna dhe Përfaqësuesin e Autorizuar të Ndërtesës Shumë-Banesore Sociale i cili të përzgjidhet nga vet banorët. Komuna do të jetë kryesuese këtij Grupi.
12. Komuna do të mbajë përgjegjësi për sigurimin në kohë të të gjitha lejeve dhe aprovimeve dhe sigurimin e kushteve teknike të nevojshme për zbatimin e PKEE, si dhe do të sigurohet të bëjë aranzhimet e nevojshme për sistemimin e familjeve për të mundësuar që punët të kryhen sipas dinamikës së planifikuar.

13. Nëse Komuna nuk i përmbushë detyrimet e marra nën këtë Marrëveshje ose i kryen ato vetëm pjesërisht ose refuzon të nënshkruajë MBF brenda afatit të përcaktuar nga FKKE, kjo Marrëveshje shkëputet me kërkesën e FKKE. Në këtë rast, Komuna do të mbulojë plotësisht të gjitha kostot e shërbimeve, punimeve dhe/ose pajisjeve që i janë ngarkuar FKKE për zhvillimin e projektit (p.sh. auditimi i energjisë, dizajni etj.) deri në datën e përfundimit të kësaj Marrëveshje, brenda afatit të përcaktuar nga FKKE dhe Rregulloret e saj të Brendshme.
14. Në rast të moszekutimit ose përmbushjes së pjesshme të përgjegjësive të shkaktuara nga ndonjë ngjarje e forcës madhore, Palët do të lirohen nga detyrimet, siç parashikojnë ligjet në fuqi.

### Neni 3

#### Caktimi i Zyrtarëve Përgjegjës

1. Komuna cakton si zyrtar përgjegjës për komunikim dhe koordinim të zbatimit të projektit:  
Hamit Mjeku, Zyrtar për Energji, hamit.mjeku@rks-gov.net,  
\_\_\_\_\_
2. FKKE cakton si zyrtar përgjegjës për komunikim dhe koordinim të zbatimit të projektit:  
Njomza Maraj, Këshilltare Teknike, njomza.maraj@fkee-rks.net,  
044144255

### Neni 4

#### Efektiviteti i MIP

1. Marrëdhëniet midis Palëve rregullohen nga kjo MIP dhe MBF. MBF e cila do të lidhet më pas, konsiderohet pjesë përbërëse e kësaj marrëveshje.

### Neni 5

#### Ligjet e aplikueshme

1. Çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga kjo MIP, e cila nuk mund të zgjidhet miqësisht ndërmjet Palëve, zgjidhet me ligjet e Republikës së Kosovës.
2. Çdo ndryshim i dispozitave nën këtë MIP bëhet me marrëveshje të ndërsjellë të Palëve duke e nënshkruar plotësim/ndryshimin e kësaj MIP.
3. MIP është bërë në gjuhën shqipe dhe/ose serbe, secila në dy (2) kopje origjinale, nga një (1) kopje për secilën Palë.



Nënshkruar nga:

Në emër të FKKE

Ahmet Ismaili

Drejtor Menaxhues

22.05.2023

Prishtinë, Republika e Kosovës

Në emër të Përfituesit

Xhafer Gashi

Kryetar i Komunës

05.2023

Obiliq, Republika e Kosovës

Shtojca 1 – Lista e Projekteve të Përzgjedhura

Nr.	Emri i projektit - Objektit	Adresa e plote e objektit/projektit	Sipërfaqja (m <sup>2</sup> )	Te dhënat tjera (numri i hyrjeve, banoreve, familjeve, etj.)
1.	Ndërtesë shumë banesore-Sociale	Rr. Kosovo B, Plemetin, Obiliq P-72602052-00913-1	1560	36 Familje, 242 Banorë
2.	Ndërtesë shumë banesore-Sociale	Rr. Kosovo B, Plemetin, Obiliq P-72614055-01358-1	1043	23 Familje, 126 Banorë
	/			

